

VENDIM
Nr. 676, datë 15.10.2014

PËR PËRCAKTIMIN E FORMATIT DHE TË ELEMENTEVE TË NJOFTIMIT
PËR BARRËN SIGURUESE DHE/OSE HIPOTEKORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 53, të ligjit nr. 10033, datë 11.12.2008, “Për lojërat e fatit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Përcaktimin e formatit dhe të elementeve të njoftimit për barrën siguruese dhe/ose hipotekore për masën e sigurimit të detyrimit ndaj Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, sipas anekseve 1 dhe 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Aneks 1

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE**

Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit

Nr. Prot,

**Datë më, 2014
Format**

**NJOFTIM I PËRGJITHSHËM PËR VENDOSJEN E BARRËS SIGURUESE
DHE HIPOTEKORE**

Nga: Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit

Adresa _____

Njoftim për publikun e interesuar

1. Mbështetur në pikën 2, të nenit 53, të ligjit nr. 10033, datë 11.12.2008, “Për lojërat e fatit”, të ndryshuar, Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit ka vendosur barrë hipotekore mbi pasurinë e subjektit:

Subjekti:

;
NIPT:

;

Adresa e biznesit _____.

2. Regjistrimet tona tregojnë se subjekti i sipërcituar nuk ka paguar në afatin e kërkuar ligjor, detyrimet si vijon:

<i>Lloji i detyrimit</i>	<i>Shuma e detyrimit</i>	<i>Gjoha</i>	<i>Kamatëvonesa</i>	<i>Gjithsej detyrime</i>

3. Subjektit të sipërcituar i është dërguar dokumenti “Njoftim për pagimin e detyrimit”, por ky detyrim nuk është paguar ende. Këto detyrime tashmë janë subjekt i masave shtrënguese në përputhje me legjislacionin përkatës.

4. Ky dokument përfaqëson barrën siguroese dhe hipotekore në favor të shtetit shqiptar, përfaqësuar nga Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, mbi të gjithë pasurinë dhe të drejtat pasurore, të cilat i përkasin këtij subjekti, lidhur me shumën e detyrimeve të papaguara në afatin e kërkuar prej tij (detyrimi 0.5 %, gjoha dhe kamatëvonesë). Vendosija e kësaj barre hipotekore/siguroese synon të garantojë pagimin e tyre në rast të mospagimit vullnetar.

5. Ky dokument synon të njoftojë të gjitha palët që kanë interesa me këtë subjekt.

Në _____, më _____, dita e _____, ora _____

Firma e Drejtorit të Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit

Vula e institucionit

Aneks 2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E FINANCAVE

Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit

Nr.. Prot,

Datë më, 2014

Format

NJOFTIMI PËR VENDOSJEN E BARRËS HIPOTEKORE/SIGURUESE

Nga: Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit

Adresa_____

Për: Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme/Regjistri i Barrëve Siguruese

Adresa:

Për njoftim: Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

Adresa:

1. Mbështetur në pikën 2, të nenit 53, të ligjit nr. 10033, datë 11.12.2008, “Për lojërat e fatit”, të ndryshuar, Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit ka vendosur barrë hipotekore/siguruese mbi pasurinë e subjektit:

Subjekti:

;

NIPT:

;

Adresa e biznesit_____.

2. Regjistrimet tona tregojnë se subjekti i sipërcituar nuk ka paguar në afatin e kërkuar ligjor, detyrimet si vijon:

<i>Lloji i detyrimit</i>	<i>Shuma e detyrimit</i>	Gjoha	<i>Kamatëvonesa</i>	<i>Gjithsej Detyrime</i>

3. Subjektit të sipërcituar i është dërguar dokumenti “Njoftim për pagimin e detyrimit”, por ky detyrim nuk është paguar ende. Këto detyrime tashmë janë subjekt i masave shtrënguese në përputhje me legjislacionin përkatës.

4. Ky dokument përfaqëson barrën hipotekore/siguruese në favor të shtetit shqiptar, përfaqësuar nga Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, mbi të gjitha pasurinë dhe të drejtat pasurore, të cilat i përkasin këtij subjekti, lidhur me shumën e detyrimeve të papaguara në afatin e kërkuar prej tij (detyrimi 0.5 %, gjoha dhe kamatëvonesë). Vendosja e kësaj barre hipotekore/siguruese synon të garantojë pagimin e tyre në rast të mospagimit vullnetar.

5. Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit ka identifikuar këto pasuri të paluajtshme/të luajtshme të subjektit_____me

NIPT_____:

5.1_____

5.2_____

5.3_____

Nëse institucioni juaj disponon të dhëna të tjera mbi pasurinë e paluajtshme/të luajtshme të debitorit, brenda 5 ditëve pune, duhet të bëni identifikimin e këtyre pasurive dhe vendosjen në hipotekë/barrë siguruese të tyre në favor të Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit deri në momentin që detyrimi i papaguar prej subjektit të jetë shlyer.

Në _____, më _____, dita e _____, ora _____

Firma e Drejtorit të Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit
Vula e institucionit